

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Portual Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**"Porti i Ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano - Faza 1"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Punë ndërtimi 45000000-7, Punime për zhvillimin e terrenit 45111291-4, Punime gërmimi 45112000-5, Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike 45231400-9, Puna e ndërtimit për linjat e komunikimit 45231600-1, Punë ndërtimi për marina 45244000-9, Puna e ndërtimit për ujrat 45247100-1, Punë ndërtimi për qëllime të ndryshme 45262600-7, Punë ndërtimi për porte 45241000-8

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**39.320.000.000** (tridhjetë e nëntë miliard e treqind e njëzet milion) **Lekë**, pa TVSH;

**391.867.649,99** (treqind e nëntëdhjetë e një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë presje nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH.

**AFATI I EKZEKUTIMIT: 40 (dyzet) MUAJ**

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5 të Dokumentet Standarde të Tenderit (DST)
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të DST

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të provuar se ofertuesi vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- a) Një dokument që vërteton se kapitali dhe asetet e Ofertuesit nuk janë objekt i deklarimit të falimentimit. Kjo certifikatë duhet të lëshohet nga autoriteti kompetent në vendin ku Ofertuesi është i regjistruar dhe operon;
- b) Struktura e detajuar organizative e Ofertuesit;

Përveç kësaj:

- Ofertuesi lejohet të kryejë veprimtari tregtare në Shqipëri dhe/ose BE;
  - Çdo aksionar i drejtpërdrejtë i Ofertuesit nuk duhet të figurojë në ndonjë listë të Kombeve të Bashkuara të personave të dyshuar për përfshirje në aktivitete terroriste ose ndonjë listë të zezë tjetër relevante kombëtare ose ndërkombëtare;
- c) Në rastin kur një ofertues përbëhet nga një Bashkim i Operatorëve Ekonomikë (BOE), çdo anëtar i BOE duhet të dorëzojë dokumentet e sipërpërmendura;
  - d) Në rastin e një Bashkim i Operatorëve Ekonomikë (BOE), duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:
    - Një marrëveshje e noterizuar në bazë të së cilës është themeluar zyrtarisht Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) dhe ku përcaktohet pjesa e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e shprehur në përqindje.
    - Prokurë të posaçme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare ndaj Republikës së Shqipërisë” dhe “Vendimet e miratuara nga Këshilli i Ministrave mbi vendimet e Këshillit të Bashkimit Europian për vitet 2021-2024, sipas listës së publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme: <https://www.punetejashtme.gov.al/>, si dhe VKM nr.1128 datë 30.12.2020 "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij objekti prokurimi dhe duke qenë se është përtej kufirit të lartë monetar, përveç kërkesave të përgjithshme ligjore parashikohen edhe disa kriteret ligjore specifike sipas praktikës më të mirë ndërkombëtare. Kërkesa të tilla sigurojnë Autoritetin Kontraktor për reputacionin dhe integritetin solid të kandidatit/ofertuesve.

Lista e të gjithë operatorëve ekonomikë, të cilët janë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, publikohet në buletin javor të njoftimeve të publikuar nga APP (Agjencia e Prokurimit Publik) në faqen e saj të internetit: <https://www.app.gov.al/>.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi do të ketë burimet e nevojshme financiare për të kryer punimet dhe do të jetë në gjendje të përballojë çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet ose nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës. Brenda këtij konteksti, Ofertuesi duhet të demonstrojë se përmbush kërkesat e mëposhtme:

- a) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023). Vlera minimale e xhiros në të paktën në njërin prej viteve të periudhës duhet të jetë të paktën e barabartë me dyfishin e vlerës së Fondit Limit;
- b) Për të verifikuar përmbushjen e kërkesës sipas (a) më sipër, Ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të pasqyrave financiare të audituara për tre vitet e përmendura, të lëshuara dhe të konfirmuara nga një kontabilist publik i certifikuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).
- c) Operatorët e huaj mund të paraqesin një deklaratë konfirmimi në rast se në vendin e tyre të origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të verifikuar bilancet financiare ose xhiron vjetore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i pikës (a) vlera e kërkuar arsyetohet si më poshtë: Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe madhësinë e punimeve, vlera minimale e xhiros duhet të jetë më shumë se dyfishi i vlerës së fondit limit;

Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit ekonomik i dokumentuar me bilance apo pasqyra financiare për tre vite buxhetore i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomikë dhe të mundësisë se tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv dhe gjendja financiare bankare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozitën financiare të operatorit ekonomik.

Përcaktimi i viteve të nevojshme për paraqitjen e bilanceve bëhet duke iu referuar Legjislacionit Shqiptar të fushës, konkretisht ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe bilancin financiar”, ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 ”Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar si dhe akteve nënligjore, udhëzimeve përkatëse.

Kriteret e vendosura janë standarte të larta ndërkombëtare të cilat synojnë vetëm rritjen e cilësisë së procedurës. Këto kritere nuk krijojnë diskriminime për Operatorët Ekonomike, përkundrazi

synojnë futjen në procedurë të Operatorëve Ekonomikë me standardet më të larta në mënyrë që të mos shfaqen probleme në realizimin e këtij objekti kompleks dhe shumë të rëndësishëm.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme<sup>1</sup>:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit,

Për më tepër, për punimet kryesore do të zbatohen kërkesat e mëposhtme për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- *Përvojë e ngjashme në dragim dhe bonifikim*: Përvoja e ngjashme në të paktën një kontratë me një vlerë totale jo më pak se 60 milion Euro, e realizuar brenda 5 (pesë) viteve të fundit;
- *Përvojë e ngjashme në ndërtimin e mbrojtjes ujore/dallgëthyes*: Përvoja e ngjashme në të paktën një kontratë me një vlerë totale jo më pak se 50 milion Euro, e realizuar brenda 5 (pesë) viteve të fundit;
- *Përvojë e ngjashme në ndërtimin e kalatave*: Përvoja e ngjashme në të paktën një kontratë me një vlerë totale jo më pak se 16 milion Euro, e realizuar brenda 5 (pesë) viteve të fundit.

OSE

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për më tepër, për punimet kryesore do të zbatohen kërkesat e mëposhtme për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- *Përvojë e ngjashme në dragim dhe bonifikim*: Përvoja e ngjashme në punime, e llogaritur si shuma e të gjithë përvojës së ngjashme në kontratat e punimeve të realizuara brenda 5 (pesë) viteve të fundit dhe me një vlerë jo më pak se 240 milion Euro.
- *Përvojë e ngjashme në ndërtimin e mbrojtjes ujore/dallgëthyes*: Përvoja e ngjashme në punime, e llogaritur si shuma e të gjithë përvojës së ngjashme në kontratat e punimeve të realizuara brenda 5 (pesë) viteve të fundit dhe me një vlerë jo më pak se 200 milion Euro.
- *Përvojë e ngjashme në ndërtimin e kalatave*: Përvoja e ngjashme në punime, e llogaritur si shuma e të gjithë përvojës së ngjashme në kontratat e punimeve të realizuara brenda 5 (pesë) viteve të fundit dhe me një vlerë jo më pak se 64 milion Euro.

---

<sup>1</sup> Sqarim: Ofertuesi duhet të përmbushë të paktën një nga kriteret e mësipërme (a ose b)

Kur oferta paraqitet nga një Bashkim i Operatorëve Ekonomikë (BOE), kushti i përcaktuar në pikën 2.3.1 të mësipërme duhet të plotësohet në përputhje me VKM 285 / 2021, Neni 88, Pika 3.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim për realizimin e punimeve ku të përcaktohet dhe përqindja e pjesëmarrjes së punës së realizuar në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor;
- Formulari i vlerësimit të punimeve të kryera;
- Kontratë;
- Situacionin përfundimtar;
- Akti kolaudimit ose /dhe Çertifikatën e marrjes në dorëzim;

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim për realizimin e punimeve ku të përcaktohet dhe përqindja e pjesëmarrjes së punës së realizuar në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor;
- Kontratë;
- Situacionin përfundimtar;
- Akti i kolaudimit ose /dhe Çertifikatën e marrjes në dorëzim;
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një punë të vetme, ose dyfish për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke qenë se fondi limit i vlerësuar është mbi kufirin e lartë monetar, vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm eksperience duke marrë parasysh kompleksitetin dhe madhësinë e punimeve.

Eksperienca e mëparshme është një kriter thelbësor i cili garanton Autoritetin Kontraktor që operatorët ekonomikë në bazë të vlerës së punëve të ngjashme të kenë kapacitetin për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të lartë cilësie. Bazuar në nenin 88 pika 1 të VKM 285/2021, parashikohet se “Oferta mund të paraqitet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku një nga ata përfaqësojnë të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës, në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit që do të kryejë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi sipas një kontratë bashkëpunimi të nënshkruar ndërmjet palëve”.

Veçanërisht, për objektin e punës së Fazës 1 (fillestare) është thelbësore që Ofertuesi të ketë përvojë të mjaftueshme të provuar dhe aktuale për përfundimin me sukses të projekteve të ngjashme, të cilat karakterizohen nga:

- Vlera e projektit: Ofertuesi duhet të demonstrojë se mund të përballojë madhësinë e parashikuar të projektit;
- Kompleksiteti i projektit: punimet detare në shkallë të gjerë (dragimi dhe depozitimi, dallgëthyesi dhe argjinatura mbrojtëse, strukturat e kalatave) që përbëjnë pjesën më të madhe të punimeve së Fazës 1 (fillestare). Ofertuesi duhet të demonstrojë se ka përvojë për të ndërtuar vepra detare të mëdha.

Kërkesat e listuara më sipër do të kufizojnë rreziqet për Autoritetin Kontraktor që lidhen me mungesën e përvojës së ofertuesit.

Konsiderojmë se kërkesat e mësipërme nuk bien ndesh me asnjë nga dispozitat ligjore të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos të gjithë Operatorët Ekonomikë/Ofertuesit në kushte të barabarta dhe u jep atyre mundësi të njëjta pjesëmarrjeje në garë.

---

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoriteti kompetent në vendin ku Ofertuesi është i regjistruar ose operon. Përndryshe, Ofertuesi duhet të paraqesë çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e tij për të ushtruar veprimtarinë profesionale në vendin e origjinës. Licencat do të mbulojnë të paktën kategoritë e mëposhtme që lidhen me kryerjen e punëve të kontratës ose çdo certifikim tjetër ekuivalent (p.sh. si Konstruktor i Përgjithshëm)<sup>2</sup>:

#### **A. Punime të përgjithshme ndërtimi**

NP-1-E Punime gërmimi në tokë;

NP-2-D Ndërtime civile dhe industriale;

---

<sup>2</sup> Sqarim: Kriteret e mëposhtme duhet të përmbushen me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit–Shtojca 10.

- NP-4-G        Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaje, metro, pista aeroportuale;
- NP-5-F        Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti;
- NP-7- D        Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje;
- NP 8-G        Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë;
- NP-9-G        Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime;
- NP-11-C       Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;
- NP-12-A       Punime të inxhinierisë së mjedisit.

### **B. Punime speciale ndërtimi**

- NS-5-A        Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut;
- NS-8-G        Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri;
- NS-9-G        Punime strukturore speciale;
- NS-10-G       Shtresa dhe strukturat speciale;
- NS-12-C       Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit;
- NS-13-D       Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- NS-14-A       Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS-15-G       Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore;
- NS-18-A       Punime topogjeodezike;
- NS-20-A       Shpime gjeologo-inxhinierike, puse dhe shpime për ujë.

#### ***Shënim:***

***Ofertuesit duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës.***

***Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat përkatëse të licencave profesionale që janë lëshuar nga vendi i tyre i origjinës sipas përcaktimeve të mësipërme. Ofertuesi i huaj duhet të ketë licencat e tij për kategoritë e punimeve që kërkojnë dokumentet e tenderit, pavarësisht se***

*kategoria e kërkuar nuk korrespondon me numrin e njëjtë të kategorisë si kategoria e punimeve në licencën e një ofertuesi të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Ofertuesi i parakualifikuar, në momentin e paraqitjes së dokumentacionit shkresor, duhet të ketë të siguruara licencat e tij të barasvlershme me licencat sipas legjislacionit përkatës shqiptar përpara se të lidhë kontratën dhe të fillojë punimet, sipas formatit të parashikuar në Vendim KM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit për subjektet juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Kjo është një kërkesë ligjore për nënshkrimin e kontratës. Mos respektimi i kësaj kërkesë brenda afatave ligjor do të çojë automatikisht në skualifikimin e Ofertuesit përkatës.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 42, date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën, zërat e punimeve dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko-profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kërkesat e listuara më sipër kufizojnë rreziqet e mundshme për Autoritetin Kontraktor lidhur me mungesën e ekspertizës profesionale të Ofertuesit.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<b>Kategoria e kërkuar</b>	<b>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>	<b>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</b>
<b>Punime të përgjithshme ndërtimi</b>		
NP-1 -E	Punime gjurmimi në tokë	201-400 milionë
NP-2-D	Ndërtime civile dhe industriale	101-200 milionë
NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Mbi 800 milionë
NP-5-F	Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti	401-800 milionë
NP-7-D	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	101-200 milionë
NP-8-G	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.	Mbi 800 milionë



NP-9-G	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.	Mbi 800 milionë
NP-11-C	Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	51-100 milionë
NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	21-50 milionë
<b>Punime speciale ndërtimi</b>		
NS-5-A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.	0-20 milionë
NS-8-G	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri	Mbi 800 milionë
NS-9-G	Punime strukturore speciale	Mbi 800 milionë
NS-10-G	Shtresa dhe mbistruktura speciale	Mbi 800 milionë
NS-12-C	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	51-100 milionë
NS-13-D	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	101-200 milionë
NS-14-A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	0-20 milionë
NS-15-G	Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore.	Mbi 800 milionë
NS-18-A	Punime topogjeodezike	0-20 milionë
NS-20-A	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.	0-20 milionë

- Shënim: Për Licencat NP-12-A, NS-18-A, NS-20-A nuk janë vendosur vlerat përkatëse për secilën kategori, pasi janë punime që përfshihen në shpenzime plotësuese që parashikohen të kryhen në vlerën 10% të të gjithë preventivit.

### **2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin si më poshtë<sup>3</sup>:**

<sup>3</sup> Sqarim: Kriteret e mëposhtme duhet të përmbushen me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit-Shtojca 10.

<b>Pozicioni</b>	<b>Diploma/Profili</b>	<b>Përvoja totale (vite)</b>
1 (një) Drejtor Projekti	Inxhinier ndërtimi/ ose i ngjashëm	25
1 (një) Menaxher Projekti	Inxhinier ndërtimi/ ose i ngjashëm	20
1 (një) Menaxher për punime ndërtimi	Inxhinier ndërtimi/ ose i ngjashëm	20
1 (një) Ekspert për ndërtim dallgëthyesish	Inxhinier Hidroteknik	15
1 (një) Ekspert Dragimi	Inxhinier Minierash / Inxhinier Ndërtimi (Certifikimi për Dragime)	15
1 (një) Ekspert për ndërtimin e Murit të Kalatës	Inxhinier i Ndërtimit (Profili Ndërtime Industriale/Strukturor)/	15
1 (një) Ekspert Guroresh/Karrierë guri	Inxhinier Ndërtimi / Inxhinier Gjeolog	15
1 (një) Ekspert për ndërtim Rrugësh & Shtresash	Inxhinier ndërtimi (Profili Transport)	15
1 (një) Ekspert Gjeoteknik	Inxhinier Ndërtimi (Profili Gjeoteknik)	15
1 (një) Inxhinier Mekanik & Elektrik	Inxhinieri Mekanik & Elektrik.	15
1 (një) Ekspert i Materialeve të Ndërtimit	Inxhinier Gjeolog/Inxhinier Ndërtimi ose diplomë të ngjashme	15
1 (një) Ekspert Ndërtesash	Inxhinier ndërtimi / Inxhinier Strukturor	15
3 (tre) Inxhinierë Ndërtimi	Inxhinier ndërtimi	15

2 (dy) Topografë	Topograf dhe hidrograf (piketime ujore)	15
------------------	---	----

**Për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve 2.3.3 ofertuesi do të sigurojë kopje të dokumenteve të mëposhtme për secilin nga stafi i mësipërm:**

- Kontratë individuale të punës ose kontratë angazhimi (faqet me informacione të sensitive financiare mund të mos dorëzohen);
- Diploma;
- Certifikatë kualifikimi ose ekuivalente;
- CV.

**Shënim:**

*- Autoriteti Kontraktor nuk synon të ketë të gjithë kontratën, por vetëm faqet që kanë të bëjnë me palët, afatin kohor, pozicionin dhe nënshkrimet, të dhëna të tjera konfidenciale ose sensitive mund të lihen jashtë.*

*Autoriteti kontraktor kërkon kontratën individuale të punës ose kontratën e angazhimit, për të vërtetuar se kapacitetin e Operatorit Ekonomik dhe disponueshmërinë e personelit përkatës të kërkuar në pikën 2.3.3, të cilët nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik sipas profilit inxhinierik ndërtim, ujqor, gjermim, gjeodezi, mjedis etj, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në kryerjen e punimeve, duke ju referuar objektit/vendndodhjes gjeografike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast mund të çojë në mosrealizim në afat dhe me cilësi të dobët të punimeve. Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: *“Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën”*.

Kriteret lidhur me numrin e viteve të përvojës në punë për stafin e paraqitur në tabelën e mësipërme bazohen në arsyetimin si vijon:

- Për shumicën e stafit: koha mesatare për tu pajisur me licencë profesionale është (10 vjet) plus koha e një kontrate të ngjashme për punime civile me përmasa të mëdha (5 vjet), arrin në 15 vjet gjithsej;

- Për pozicionet më të larta të Menaxherit të Projektit dhe Menaxherit të Ndërtimit: vlen i njëjti arsyetim, megjithatë me dyfishin e përvojës përkatëse në projekt (pra, 10 vjet, plus 2 herë 5 vjet);
- Për pozicionin e Drejtuesit të Projektit: vlen i njëjti arsyetim, megjithatë me trefishin e përvojës përkatëse në projekt (pra, 10 vjet, plus 3 herë 5 vjet).

Menaxheri i projektit është përgjegjës për kryerjen e punimeve në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe sigurinë në punë brenda kushteve të kontratës.

Theksojmë, stafi kyç i lartpërmendur mbulon disiplinat kryesore të kërkuara për përfundimin me sukses të fushës së punës së Fazës 1 (fillestare). Duke pasur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e Projektit, stafi duhet të ketë përvojë të rëndësishme të dëshmuar në punë të ngjashme, por edhe në nivel të ngjashëm.

Kërkesat e listuara më sipër do të kufizojnë rreziqet për Autoritetin Kontraktor që lidhen me mungesën e përvojës së stafit kryesor.

#### 2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të kenë personel të kualifikuar/certifikuar në stafin e tyre si<sup>4</sup>:

Pozicioni	Diploma/Certifikata	Përvoja totale (vite)
1 (një) Ekspert i ndihmës së parë dhe ndërhyrjes emergjente	Inxhinier ndërtimi ose i ngjashëm Çertifikuar si "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen emergjente" në bazë të standarteve ekuivalente kombëtare ose ndërkombëtare	15
1 (një) Ekspert i sigurisë dhe shëndetit në punë	Inxhinier ndërtimi/ose i ngjashëm Çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në bazë të standarteve ekuivalente kombëtare ose ndërkombëtare	15
1 (një) inxhinier mjedisi	Inxhinier Mjedisi/ose i ngjashëm Çertifikuar për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në bazë të standarteve ekuivalente kombëtare ose ndërkombëtare	15

**Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 6/ ç dhe 6/ d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për

<sup>4</sup> Sqarim: Kriteret e mëposhtme duhet të përmbushen me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit-Shtojca 10.

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ky kriter kërkon që operatorët ekonomikë të provojnë se kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, e cila është në dispozicion ose mund të vihet në dispozicion të ekonomisë. operatori për të realizuar kontratën si dhe mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit që operatori ekonomik ka ose mund të vihet në dispozicion për ekzekutimin e kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe të ligjit nr.10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri të veçanta dhe përgatitje për vlerësime të sakta për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë Në rregulloren për sigurinë në kantierin e miratuar me VKM nr , duhet të ndjekë kurset përkatëse të trajnimit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës kërkesat e sigurisë për kantieret e përkohshme ose të lëvizshme, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes Operatori/ët ekonomik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, duhet të kenë kualifikimet dhe dokumentet përkatëse në lidhje me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimin mjedisor, për rastet e ndotja e parashikuar në VKM nr. 312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt, person fizik apo juridik, për parandalimin dhe uljen e rreziqeve për jetën dhe shëndetin e njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, për përfitimin e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garancia e ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe e papritur në punë dhe dokumentet përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindje dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Në funksion të rëndësisë së shëndetit, sigurisë dhe mjedisit në përgjithësi dhe në funksion të rreziqeve të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit që lidhen me ndërtimin e një projekti të madh, kompleks detar si projekti i Fazës 1 (fillestare), kërkohet edhe personeli.

Kërkesat e listuara më sipër do të kufizojnë rreziqet për Autoritetin Kontraktor që lidhen me mungesën e personelit të kualifikuar shëndetësor, sigurisë dhe mjedisit të mjaftueshëm brenda organizatës së ofertuesve.

### **2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 500 persona gjatë periudhës së fundit të deklaruar nga data e shpalljes së tenderit duke përfshirë stafin e ekspertëve kyç.<sup>5</sup>**

**Sa më sipër do të vërtetohet nga Ofertuesi duke ofruar kopje të dokumentacionit të mëposhtëm:**

Vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore për periudhën e fundit të deklaruar (**Muaji Korrik**) nga data e shpalljes së tenderit, shoqëruar me listëpagesën e ofertuesit sipas një formati të kërkuar nga legjislacioni tatimor përkatës.

Sipas pikës 2.3.5 të Dokumentacionit të Tenderit, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë një fuqi punëtore prej minimalisht 500 persona gjatë periudhës së fundit të deklaruar (muaji) nga data e shpalljes së tenderit, duke përfshirë stafin e ekspertëve kyç. Kjo kërkesë është e justifikuar për arsyet e mëposhtme ligjore dhe teknike:

---

<sup>5</sup> Sqarim: Kriteret e mësipërme duhet të përmbushen me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit–Shtojca 10.

### *Kompleksiteti i Projektit*

- Projekti për zhvillimin e portit të Porto Romanos përfshin aktivitete të gjera dhe komplekse, duke përfshirë dragimin, bonifikimin, ndërtimin e mureve të kalatave dhe ndërtimin e dallgëthyesve. Secila nga këto aktivitete kërkon një sasi të konsiderueshme të fuqisë punëtore për të siguruar ekzekutimin në kohë dhe me efikasitet. Për shembull, kërkesat për stafin dhe punëtorët për ndërtimin tipik të terminalit janë si më poshtë:

- Menaxhimi dhe Mbështetja: Menaxher projekti, zëvendës menaxher projekti, staf sekretarial, menaxher zyre, QS, financa/pagave, prokurim, testim, HR & siguri, shoferë, dhe mekanikë.

- Dragimi dhe Bonifikimi: Ekipet e survejimit, ekuipazhi i draguesit, ekuipazhi i bonifikimit, dhe kolona guri.

- Muret e Kalatave dhe Dallgëthyesit: PC yard & batch plant, palosje, beton in-situ, survejim, dhe gurore.

- Ndërtesat dhe Shërbimet: Shtresa e betonit & drenazh, ndërtesa, elektrike, ujë & kanalizime, dhe survejim.

- Staf total i kërkuar për këto aktivitete arrin në të paktën 500 punonjës njëkohësisht.

Kërkesa për një fuqi punëtore prej minimalisht 500 individësh është një masë e arsyeshme dhe e nevojshme për të siguruar që projekti për zhvillimin e portit të Porto Romanos të realizohet me sukses, brenda afateve kohore dhe me standarde të larta cilësie. Ajo garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin, ekspertizën dhe burimet për të përmbushur kërkesat e projektit, të përmbushë standardet ligjore dhe të menaxhojë proceset e ndërvarura të punës në mënyrë efikase.

<b>Kat.</b>	<b>Shpjegimi</b>	<b>Nr. i Pozicioneve</b>	<b>Turne</b>	<b>Total</b>
<b>Stafi dhe puna e vlerësuar për ndërtimin tipik të terminalit</b>				
1.1	Menaxhimi dhe mbështetje			
	Menaxher i Projektit	1	1	1
	Zëvendës menaxher projekti	1		
	Sekretariat	4	1	4
	Menaxher zyre	1	1	1
	Kontrollor	3	1	3
	Financiare/Paga	3	1	3
	Prokurimi	4	1	4
	Testime	2	1	2
	HR dhe siguria	2	1	2
	Drejtues	3	2	6
	Mekanika	5	2	10
1.2	Gërmimi, bonifikimi dhe dherat	12	1	12
	Ekipet anketuese (topo dhe hidrografike)	8	1	8
1.3	Kalata			
	Sheshet	4	1	4
	Grumbullim	4	1	4
	Betoni insitu (kuvertë)	5	1	5
	Anketa	6	1	6
	Guroret	2	1	2
1.4	Trotuaret, ndërtesat dhe shërbimet komunale			

	Trotuare & kullues	3	1	3
	Ndërtesat	5	1	5
	Elektrike	4	1	4
	Ujësjiellës-kanalizime	2	1	2
	Kërkimet	6	1	6
	<b>Stafi total</b>			<b>97</b>
2.1	Gërmimi dhe bonifikimi			
	Ekuipezimi i dragerit	30	3	90
	Bonifikimi	10	3	30
	Kolona prej guri	20	1	20
2.2	Kalata			
	Sheshet	12	2	24
	Grumbullim	10	2	20
	Transport & vinça	12	2	24
	Insitu beton (kuvertë), mobilje në kalatë	30	2	60
2.3	Ujërat valëzues	20	2	40
2.4	Trotuaret, ndërtesat dhe shërbimet komunale			
	Rruga	25	1	25
	Ndërtesat	40	1	40
	Shërbimet komunale	30	1	30
	<b>Punëtorja totale</b>			<b>403</b>
	<b>Punonjës Total</b>			<b>500</b>

**2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme<sup>6</sup>:**

Nr	Emri i pajisjes/mjetit	Njësia	Numri	Statusi
1	Pajisjet e dragimit dhe depozitimit			
1.1	Rimorkio e Dragës Thithëse me volum minimal të depozitimit 8000m <sup>3</sup> dhe një thellësi minimale dragimi prej 18 m	copë	3	Në pronësi ose me qira
1.2	Dragë thithëse prerëse me një fuqi minimale totale të instaluar prej 10,000 kW dhe një thellësi minimale dragimi prej 18 m	copë	2	Në pronësi ose me qira

<sup>6</sup> Sqarim: Kriteret e mëposhtme duhet të përmbushen me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit-Shtojca 10.

1.3	Dragë Backhoe (e stacionuar me ekskavator hidraulik të instaluar) me një thellësi minimale dragimi prej 18 m	copë	2	Në pronësi ose me qira
1.4	Barga Depozitimi (vëllimi minimal të depozitimit prej 8000 m <sup>3</sup> )	copë	3	Në pronësi ose me qira
2	Vinç Backhoe (i stacionuar me ekskavator hidraulik të instaluar) (minimumi 50t)	copë	5	Në pronësi ose me qira
3	Vinç me zinxhir (minimumi 100t)	copë	4	Në pronësi ose me qira
4	Kamion Transporti Shkarkues (ngarkesë minimale 25t)	copë	23	Në pronësi ose me qira

Për pajisjet e mësipërme të ndërtimit, ofertuesi do të dorëzojë sa më poshtë:

- Vërtetimi i pronësisë ose kontratat e qirasë.
- Gjithashtu do të dorëzohen foto të qarta dhe fletë teknike për secilën pajisje individuale.

Ofertuesi duhet të dorëzojë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e pajisjeve të mësipërme të ndërtimit gjatë gjithë periudhës së kontratës së punimeve.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në kontratën e pronës/qirasë/furnizimit vlerësohen si të nevojshme në raport me natyrën dhe madhësinë e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, grafikut të punës dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve të analizës teknike. Për zbatimin e kontratës, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë dokument konkret do të sigurohet nga operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike, operatorët ekonomikë dëshmojnë se posedojnë kapacitetet e nevojshme teknike, profesionale, organizative, makineritë, pajisjet dhe mjetet tjera fizike, aftësi organizative.



Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të njohur kapacitetin dhe aftësinë e operatorit për të përmbushur me sukses kontratën si dëshmi për pajisjet sipas specifikimeve.

Vendosja e këtij kriteri është në përpjestim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës. Operatorët ekonomikë kërkesat për pajisjet në pronësi, mund ti plotësojnë edhe duke i marrë ato me qira. Lidhur me pajisjet Autoriteti Kontraktor ka patur parasysh projektin, preventivin dhe relacionin teknik.

Nr	Emri i pajisjes/mjetit	Njësia	Numri	Argumentimi
1	Pajisjet e dragimit dhe depozitimit			
1.1	Rimorkio e Dragës Thithëse me volum minimal të depozitimit 8000m <sup>3</sup> dhe një thellësi minimale dragimi prej 18 m	copë	3	Bazuar në vëllimet e vlerësuara, shkallët e shfrytëzimit dhe muajt e nevojshëm, duhet të ketë 2 Rimorkio të Dragës Thithëse. Draga e tretë shërben si rezervë për të parandaluar vonesat e projektit për shkak të dështimeve mekanike ose nevojave për mirëmbajtje. Kjo rezervë siguron që afati kohor i dragimit të projektit të mbetet i pandërprerë.
1.2	Dragë thithëse prerëse me një fuqi minimale totale të instaluar prej 10,000 kW dhe një thellësi minimale dragimi prej 18 m	copë	2	Bazuar në vëllimet e vlerësuara, shkallët e shfrytëzimit dhe muajt e nevojshëm, duhet të ketë 1 dragë me prerje. Përdorimi i dy dragave me prerje, secila me një fuqi të instaluar minimale prej 10,000kW dhe e aftë të dragojë në një thellësi prej 18 metrash, është thelbësore për të përmbushur kërkesat e dragimit të projektit. Njësia e parë do të angazhohet aktivisht në aktivitete dragimi, ndërsa njësia e dytë do të qëndrojë në gadishmëri për të siguruar vazhdimësinë operacionale në

				rast të dështimit të pajisjeve, duke siguruar zbatimin e grafikut të punimeve.
1.3	Dragë Backhoe (e stacionuar me ekskavator hidraulik të instaluar) me një thellësi minimale dragimi prej 18 m	copë	2	Për detyrat specifike të dragimit që nuk janë të përshtatshme për lloje të tjera dragash angazhimi i dy dragave backhoe, secila e aftë të gërmojë në një thellësi prej 18 metrash, është thelbësore. Njësia e parë do të jetë operacionale, ndërsa njësia e dytë do të qëndrojë në gadishmëri për të parandaluar ndërprerjet e projektit për shkak të çështjeve mekanike, duke siguruar progres punimesh të pandërprerë.
1.4	Barga Depozitimi (vëllimi minimal të depozitimit prej 8000 m <sup>3</sup> )	copë	3	Projekti kërkon përdorimin e tre bargave depozituese, secila me një vëllim minimal depozitimi prej 8000m <sup>3</sup> , për të transportuar në mënyrë efikase materialin e draguar. Për të optimizuar efikasitetin operacional, një bargë do të ngarkohet ndërsa tjetra përgatitet për ngarkimin e radhës dhe me bargën e tretë si rezervë. Kjo strategji operacionale minimizon kohën e ndërprerjes dhe maksimizon prodhimin.
2	Vinç Backhoe (i stacionuar me ekskavator hidraulik të instaluar) (minimumi 50t)	copë	5	Përdorimi i pesë vinçave backhoe (të stacionuar), secili me një kapacitet ngritjeje minimal prej 50 tonësh, është i justifikuar nga kërkesat e projektit për ndërtimin e dallgëthyesave dhe argjinaturave mbrojtëse. Dy vinça do të

				alokohen për secilin dallgëthyes për të siguruar ndërtim të njëkohshëm dhe efikas, ndërsa vinçi i pestë do të jetë i dedikuar për punën e argjaturës mbrojtëse. Ky alokim është thelbësor për të mirëmbajtur afatet e projektit dhe për të siguruar trajtimin efikas të materialeve të rënda.
3	Vinç me zinxhir (minimumi 100t)	copë	4	<p>Alokimi i katër vinçave me zinxhir secili me një kapacitet ngritjeje minimal prej 100 tonësh, bazohet në nevojat e ndryshme për ngritje të projektit. Vinçat do të alokohen strategjikisht si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një njësi (vinç) për sheshin e para-fabrikimit.</li> <li>- Një njësi për kalatën jugore të dallgëthyesit.</li> <li>- Një njësi për hedhjen e betonit në kantier.</li> <li>- Një njësi për vendosjen e elementeve të parafabrikuar.</li> </ul> <p>Kjo shpërndarje siguron që të gjitha operacionet kritike të ngritjes janë të mbështetura, duke reduktuar kështu rrezikun e vonësive dhe duke rritur produktivitetin e përgjithshëm të projektit.</p>
4	Kamion Transporti Shkarkues (ngarkesë minimale 25t)	copë	23	<p>14m<sup>3</sup> për 25 ton ngarkesë</p> <p>4km distanca e depozitimit/një cikël</p> <p>Një cikël i ngarkimit/shkarkimit të kamionit do të zgjasë ~1.5 orë</p> <p>14*12/1.5=112m<sup>3</sup>/ditë për 1 kamion</p>

			<p><u>Dallgethyësi Verior (Material Shkëmb)</u></p> <p><math>500000\text{m}^3/(23*25\text{ ditë/m})=900\text{m}^3/\text{ditë}</math></p> <p><math>(900\text{m}^3/\text{ditë})/112=8</math> <b>kamionë për DV gjithsej</b></p> <p><u>Dallgethyësi Jugor (Material Shkëmb)</u></p> <p><math>500000\text{m}^3/(23*25\text{ ditë/m})=900\text{m}^3/\text{ditë}</math></p> <p><math>(900\text{m}^3/\text{ditë})/112=8</math> <b>kamionë për DJ gjithsej</b></p> <p><u>Argjinatura mbrojtëse e Basenit lindor (Material Shkëmb)</u></p> <p><math>405000\text{m}^3/(23*25\text{ ditë/m})=700\text{m}^3/\text{ditë}</math></p> <p><math>(700\text{m}^3/\text{ditë})/112=7</math> kamionë për argjinaturën mbrojtëse.</p>
--	--	--	--

### 2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta kualifikimi / kopje të certifikatave të cilësisë që do të dorëzohen nga ofertuesi:

- EN-ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent;
- EN-ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalent;
- ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalent.

\* Të gjitha certifikatat e mësipërme, ose ekuivalentet e tyre, duhet të lëshohen nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organet kombëtare të akreditimit ose nga një organ ndërkombëtar akreditimi. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zerave të punëve që do të marrë persiper të realizojë sipas akt marreveshjes.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për shkak të natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe madhësisë së objektit që do të prokurohet, është jashtëzakonisht e rëndësishme që operatorët ekonomikë, si ekzekutues të punës, të kryejnë aktivitetin me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat synon të arrijë zbatimin me sukses të projektit. Këto certifikata janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe do të t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të njohur kapacitetet e operatorëve ekonomikë dhe aftësinë e tyre për të ekzekutuar plotësisht kontratën. Referuar nenit 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë përputhjen e kandidatit ose ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë standardet për menaxhimin mjedisor, shëndetin dhe sigurinë në punë. .

Certifikimi i lartpërmendur është certifikimi minimal i kërkuar për të gjitha projektet e ndërtimit detar me përmasa të mëdha. Kërkesat e listuara më sipër do të kufizojnë rreziqet për Autoritetin Kontraktor lidhur me mungesën e cilësisë në ekzekutimin e proceseve thelbësore për realizimin e punimeve të Fazës 1 (fillestare).

### **Shënim:**

***Për operatorët e huaj ekonomikë të regjistruar në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 tetor 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja”.***

***Për operatorët e huaj ekonomikë që janë regjistruar në vende që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës të datës 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizimin diplomatik dhe konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, legalizimi i këtyre dokumenteve duhet të bëhet në ambasada, konsullata ose zyra përkatëse në vendin e origjinës.***

***Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.***

***Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, apo dokumente të rreme dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

***Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e DST.**

## **Argumentimi mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit pa e ndarë në lote**

Autoriteti Portual Durrës ka vendosur të zhvillojë procedurën e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar pa e ndarë atë në lote, bazuar në parashikimet e punimeve për objektin sipas kontratës: "Projekti i Detajuar i Portit të Ri të Integruar Tregtar të Durrësit në Porto Romano".

Autoriteti Kontraktues e gjen teknikisht të pamundur ndarjen e këtij projekti në lote të veçanta. Gjithashtu, dokumentacioni teknik, duke përfshirë Raportin Teknik, Specifikimet Teknike dhe Parashikimin e Punimeve të përgatitur nga projektuesi, tregon qartë se proceset e punës për këtë objekt janë ngushtë të lidhura me njëra-tjetrën. Prandaj, është e pamundur për Autoritetin Kontraktues të përcaktojë paraprakisht se cilat vëllime duhet të ndahen. Pjesa më e madhe e fazës së parë të zhvillimit të projektit për portin e Porto Romanos përfshin aktivitete të dragimit dhe bonifikimit, ndërtimin e mureve të kalatave dhe ndërtimin e dallgëthyesve. Këto aktivitete janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe ndarja e tyre në kontrata të veçanta rrit profilin e përgjithshëm të riskut të projektit për shkak të ndërveprimeve kontraktuale që krijohen. Bashkimi i të gjitha këtyre komponentëve në një kontratë të vetme eliminon këto ndërveprime kontraktuale, duke ulur mundësinë e pretendimeve kontraktuale dhe duke reduktuar profilin e riskut të projektit. Gjithashtu, një qasje me një kontratë të vetme e bën projektin më tërheqës komercialisht për kontraktorët e kualifikuar ndërkombëtarë, duke rritur gjasat për marrjen e ofertave më konkurruese.